



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
SEKTORI I KOORDINIMIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion ardhur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) me e-mailin e datës 21.11.2024, në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar kërkon informacion mbi konsultimin e dokumentit "Udhërrëfyeni për Reformën në Administratën Publike", ju informojmë se:

Konsultimi publik është një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes me ndikim në rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike, si dhe forcimin e demokracisë.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik" parashikohet se aktet që i nënshtrohen konsultimit publik janë projektligjet dhe projektvendimet që miratojnë dokumente strategjike dhe politika me interes të lartë publik.

"Udhërrëfyeni për Reformën në Administratën Publike 2023-2030" është një dokument politik që mbështet reformën në administratën publike, me një plan masash prioritare, për periudhën kohore 2023 – 2030.

Ky Udhërrëfyeni është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike, me përfshirjen e institucioneve të përcaktuara në shtojcën nr. 2 të Urdhrit nr. 57, datë 24.04.2023 "Për disa shtesa në urdhrin nr. 94, datë 20.05.2019 të Kryeministrit 'Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian'.

Udhërrëfyeni për Reformën në Administratën Publike 2023 – 2030 u miratua me VKM-në nr. 737, datë 13.12.2023.

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Administratës Publike ka realizuar procesin e konsultimit publik për draftin e "Dokumentit të masave prioritare në kuadër të Reformës së Administratës Publike 2023 - 2030".

Duke mbajtur në konsideratë që fusha e veprimit të projektvendimit ishte e gjerë dhe si rezultat palët e interesuara mund të ishin të shumta, publikimi i tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u vlerësua si një nga metodat më efektive për konsultimin publik.

Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, është zhvilluar përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet në linkun: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Qytetar?page=11>

Ky konsultim publik i shtrirë në dy (II) faza ka patur 2591 shikime dhe dy komente.

Faza e parë e konsultimit u hap me publikimin e projektvendimit në RENJK më datë 09.09.2023 dhe u mbyll më 06.10.2023 në linkun: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/655>

Këtu gjendet njoftimi për konsultim publik dhe koncepti i dokumentit të masave prioritare.

Ri-Konsultimi ose faza e dytë me draftin e përmirësuar u hap me publikimin e projektvendimit në RENJK më datë 10.10.2023 dhe u mbyll më 07.11.2023 në linkun:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/663>

Këtu gjendet njoftimi për konsultim publik, koncepti i dokumentit të masave prioritare i përmirësuar si edhe komentet e shprehura nga qytetarët.

Në përfundim të konsultimit elektronik, megjithëse numri i vizitorëve në RENJK ishte i konsiderueshëm (në total në fazën e I nr. Shikimeve ishte 1259 dhe nr. Komenteve ishte 0) dhe (në total në fazën e II nr. Shikimeve ishte 1332 dhe nr. Komenteve ishte 2), rezultoi se nuk kishte komente në lidhje me projektvendimin.

Që në fazat e hershme të hartimit të dokumentit janë organizuar konsultime paraprake të cilat kanë konsistuar në:

- Konsultime nëpërmjet email. Dokumenti në fazat e para (duke filluar nga muaji maj i vitit 2023) i është dërguar për mendim dhe konsultim të gjithë aktorëve dhe institucioneve të përfshira;
- Konsultime online. Dokumenti është konsultuar në të gjitha fazat dhe në takime të dedikuara online për të reflektuar gjetjet nga raporti screening dhe rekomandimet nga progresi i raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023.

Pjesëmarrës të përfshirë në procesin e konsultimit të përcaktuara në shtojcën nr. 2 të Urdhrit nr 57, datë 24.04.2023 ishin:

- Ministër i Shtetit për Standartet e Shërbimeve;
- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Departamenti i Politikës dhe Integritetit Evropian;
- Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave;
- Kryeministria;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Ministria e Financave;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAK);
- Agjencia për Mbështetjen dhe Vetëqeverisjen Vendore (AMVV);

- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB);
- Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA);
- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC);
- Inspektoriati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP);
- Avokati i Popullit (AV);
- Kuvendi;
- Instituti i Statistikave;
- Komisioni i Prokurimit Publik (KPP);
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).

Pjesëmarrës të tjerë ishin:

- Organizata ndërkombëtare;
- Përfaqësues të SIGMA;
- Përfaqësues të Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA);
- Organizata jo-qeveritare vendase;
- Ekspertë të fushës;
- Ekspertë nga bota akademike;
- Ekspertë të pavarur;
- Aktorë të tjerë të përfshirë në proces.

Dokumenti i masave prioritare të Reformës së Administratës Publike është konsultuar me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të universiteteve në disa tryeza konsultimi, të mbajtura përkatësisht në datat 14.09.2023, 27.09.2023 dhe 12.10.2023.

- Në takimin e datës 14 shtator 2023 morën pjesë 33 pjesëmarrës, nga këta 13 ishin aktorë të jashtëm;
- Në takimin e datës 27 shtator 2023 morën pjesë 13 pjesëmarrës nga bota akademike;
- Në takimin e datës 12 Tetor 2023 morën pjesë 11 pjesëmarrës aktorë të përfshirë në proces.

Në totalin e tij Konsultimi Publik për draftin e "Dokumentit të masave prioritare në kuadër të Reformës së Administratës Publike 2023 -2030", është zhvilluar dhe shtrirë në disa faza si në vijim:

- Konsultime në tryeza të përbashkëta pune. Dokumenti është konsultuar me institucionet përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e Udhërrëfyesit, ekspertë të fushës, përfaqësues të BE-së, përfaqësues të SIGMA-s, etj.
- Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, pra përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (faza e parë);

- Ri-konsultim në faqen zyrtare të konsultimit publik, publikimi i dokumentit pas reflektimit të komenteve pra përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (faza e dytë).
- Konsultimet përmes zhvillimit të takimeve dhe tryezave të partneritetit me përfshirje të gjerë të aktorëve gjithashtu rezultuan në dhënien e komenteve në nivel teknik dhe në nivel produkti për përmirësimin e masave të përfshira në dokument;

Rreth konsultimeve, më shumë se 10 palë të interesuara janë përfshirë në dhënien e komenteve, të cilat për shkak të ngashmërisë dhe përsëritjes janë grupuar në 4 tematika kryesore.

Rekomandimet dhe komentet e marra kanë patur këto tematika:

1. procesi i vlerësimit të ndikimit rregullator të zgjerohet në legjislacionin dytësor me karakter normativ dhe në fushat me interes të lartë publik si mjedisi, ekonomia dhe çështjet sociale;
2. forcimi i kulturës së pjesëmarrjes së publikut dhe i aktorëve të tjerë, dhe rritja e llogaridhënies së institucioneve në proceset e vendimmarrjes përmes konsultimit publik;
3. vënia në zbatim e programeve të posaçme të krijuara për të tërhequr nëpunës civilë të kualifikuar dhe potencialë, të hartuara dhe zbatuara;
4. përmirësimi i shërbimit ndaj klientit dhe aksesueshmërisë, modernizimi i arkitekturës së shërbimit ndaj klientit për ta bërë më të lehtë aksesin në shërbimet dhe asistencën digjitale, duke përfshirë grupet e synuara vulnerabël.

Numri i komenteve dhe rekomandimeve të marra gjatë konsultimit publik përmes RENJK ka qenë 2 (dy).

Komenti i parë sa i përket çështjeve të bazuara duhet thënë që kishte gjetur mbështetje në dokumentin e publikuar sa i përket forcimit të kapaciteteve, çështje të tjera në këtë koment ishin pikëpamje dhe qëndrime personale. Komenti i dytë është pranuar duke synuar parashikimin e masave për ta bërë punën në administratën publike më fleksibël.

Komentet e lëna në takimet e zhvilluara online ose prezent janë reflektuar plotësisht.

Me përfundimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për RAP 2015-2022, Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni përgjegjës ka nisur procesin e hartimit të strategjisë së re 2024 – 2030 duke organizuar disa takime konsultative për të.

Gjatë gjithë vitit 2024 janë marrë masa për të finalizuar draft dokumentin strategjik në linjë me masat e parashikuara në udhërrëfyes, si më poshtë vijon:

- është hartuar draft dokumenti strategjik SNRAP 2030 dhe plani i veprimit për të gjitha shtyllat e strategjisë;
- draft dokumentet janë ndarë me institucionet përkatëse për komente fundore të cilët kanë bërë rregullimet dhe ndryshimet e mundshme të cilat janë përcjellë pranë DAP;

- është konsoliduar dhe finalizuar draft pasaporta e indikatorëve;
- janë zhvilluar takime të dedikuara me institucionet për ndryshime dhe koordinime të mundshme;
- ka vijuar procesi i kostimit të planit të veprimit me mbështetjen e projektit EU for Good Governance;
- ka vijuar procesi i rishikimit të draftit përfundimtar me mbështetjen e projektit EU for Good Governance.

Në vijim e gjithë paketa do të konsultohet dhe në takime të dedikuara për konsultimin publik.

DAP gjatë përgatitjes së raporteve të Konsultimit Publik, ka pasur vazhdimisht mbështetje nga Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ata janë asistuar nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit lidhur me procesin e publikimit të raporteve në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 39, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Bashkëlidhur lutemi gjeni:

1. Dokument pune gjatë fazës fillestare të hartimit të draftit të dokumentit - koncept dokumenti;
2. Ftesat e dërguara nëpërmjet postës elektronike në datat 14.09.2023, 27.09.2023 dhe 12.10.2023, drejtuar fokus grupeve, partnerëve të institucionit, akedemikëve, ekspertë të fushës kombëtare dhe ndërkombëtare, aktorë të tjerë të përfshirë në proces;
3. Agjenda e takimeve në datat 14.09.2023, 27.09.2023 dhe 12.10.2023;
4. Minutat e takimit;
5. Informacion nëpërmjet e-mail-it dhe në RENJK mbi afatet e pranimi të komenteve/rekomandimeve dhe kanalet përkatëse për pranimin e tyre;
6. Listëprezencat nga takimet e zhvilluara në datat 14.09.2023, 27.09.2023 dhe 12.10.2023, ku kanë marrë pjesë fokus grupe, partnerë të institucionit, akedemikë, ekspertë të fushës kombëtare dhe ndërkombëtare, aktorë të tjerë të përfshirë në proces;
7. Njoftimet për konsultim publik në RENJK për të dyja fazat;
8. Koncept dokumenti i publikuar për të dyja fazat në RENJK;
9. Raport përmbledhës për proceset e konsultimit, ku përfshihen edhe vlerësimet e rekomandimeve të marra nga procesi i konsultimit.
10. VKM-në nr. 737, datë 13.12.2023 (dokumenti strategjik i miratuar).